




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



V E N D I M

Nr. 23 , datë 13.1.2022

P Ë R

DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.135,
DATË 7.3.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN
E STATUTIT TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të nenit 20, të ligjit nr.57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.135, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Fjalja e dytë, e kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Shërbimi Social Shtetëror ka si mision të sigurojë ofrimin cilësor të shërbimeve për çështjet e ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror."

b) Në kreun II bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm, të nëpunësve dhe të punonjësve administrativë të Shërbimit Social Shtetëror, në nivel qendror e rajonal, rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës. Procedura e rekrutimit të drejtorit të Përgjithshëm dhe të nëpunësve kryhet sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për mbrojtjen sociale."

ii. Pas pikës 5 shtohen pikat 5/1 e 5/2, me këtë përmbajtje:

“5/1. Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së emërohet me urdhër të ministrit përgjegjës për mbrojtjen sociale dhe duhet të plotësojë këto kritere:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të ketë diplomë të arsimit të lartë;
- ç) Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- d) Të mos ketë konflikt interesi me detyrën, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave.

5/2. Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së lirohet nga detyra kur:

- a) plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë;
- b) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- c) deklarohet i paafte për punë nga komisioni kompetent mjekësor;
- ç) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit;
- d) jep dorëheqjen nga detyra;
- dh) kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës.”.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

**MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**

OGERTA MANASTIRLIU

NR.PROT. 178/1
DATE 14.1. 2022

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE
SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

